

BRUNILDA VËRÇANI

**FORMAT E PASHTJELLUARA TË FOLJES SI PJESË E
KALLËZUESIT NË GJUHËN GJERMANE DHE ATË SHQIPE**

Ky punim synon të studiojë përdorimin e formave të pashtjelluara të foljes së gjuhës gjermane si pjesë e kallëzuesit dhe t'i krahasojë ato me të njëjtin përdorim të formave të pashtjelluara të foljes në shqipen standarde. Përmes këtij studimi synohet të dalë në pah fakti nëse dalin të gjitha format e pashtjelluara të gjermanishtes dhe të shqipes në këtë funksion sintaksor, e nëse jo, cilat janë ato forma që shfaqen në këtë funksion. Gjithashtu synohet të gjenden të përbashkëtat dhe dallimet, që i karakterizojnë këto forma të të dyja gjuhëve në funksionin e tyre si pjesë e kallëzuesit.

1. Format e pashtjelluara të foljes në gjuhë të ndryshme të botës kanë funksione të ndryshme sintaksore. Edhe në gjuhën gjermane shohim që funksionet sintaksore të tyre janë të ndryshme, gjë që vëmë re edhe në gjuhën shqipe. Një interes të veçantë ngjall përdorimi i tyre si pjesë e kallëzuesit, funksion i cili nuk kryhet nga të gjitha format e pashtjelluara. Themi pjesë e kallëzuesit pasi format e pashtjelluara nuk i gëzojnë kategoritë e formave të pashtjelluara të foljes: kohës, vetës, numrit, kategori që duhet t'i zotërojnë folja me të cilën shprehet kallëzuesi. Prandaj nuk mund të flasim për forma të pashtjelluara në funksion të kallëzuesit, por vetëm për forma të pashtjelluara që shfaqen si pjesë e tij. Kjo është karakteristikë e gjermanishtes pasi në shqipe gjejmë edhe kallëzues të shprehur me forma të pashtjelluara.

Në gjermanisht format e pashtjelluara që dalin në këtë funksion janë infinitivi dhe participi II, ndërsa participi I jo dhe në këtë funksion ato dalin vetëm kur kemi të bëjmë me kallëzues të përbërë, pasi siç u përmend më lart kallëzuesi nuk mund të shprehet me forma të pashtjelluara e aq më tepër kallëzuesi i thjeshtë. Si pjesë e kallëzuesit ato lidhen me foljen e shtjelluar dhe së bashku formojnë kallëzuesin.

Edhe në gjuhën shqipe kallëzuesi foljor mund të jetë i thjeshtë ose i përbërë, por në ndryshim nga gjermanishtja format e pashtjelluara të foljes mund të jenë pjesë si e kallëzuesit të thjeshtë ashtu edhe e atij të përbërë. Madje i gjithë kallëzuesi foljor mund të shprehet me një formë të pashtjelluar pranë një kryefjale të shprehur me emër ose me përemër vetor të të tria vetave e me përemra të tjerë me të cilët hyjnë në marrëdhënie kallëzuesore¹.

2. Format e pashtjelluara të gjermanishtes si pjesë e kallëzuesit.

¹ *Gramatika e gjuhës shqipe* 2, Tiranë, 2002, f. 179.

Siç e përmendëm më lart format e pashtjelluara të gjermanishtes që përdoren si pjesë të kallëzuesit janë infinitivi dhe participi II².

Infinitivi i gjermanishtes shfaqet si pjesë e kallëzuesit kur lidhet me foljet ndihmëse **haben** (kam) dhe **sein** (jam) dhe me pjesëzën **zu** për të shprehur një domosdoshmëri ose mundësi të kryerjes së veprimit³.

... der Dialekt ... der Künstler war zu unterscheiden / ishte për t'u dalluar dialekti artistëve / duhej dalluar dialekti i artistëve

... wo man... zu warten hatte / ku... duhej të prisje

Gjithashtu infinitivi është pjesë e kallëzuesit kur lidhet me foljet modale, rast në të cilin ai përdoret pa pjesëzën **zu**: Was müssen wir denn noch *besprechen*? / çfarë duhet të diskutojmë ende?; ose në lidhje me folje të ngjashme me ato modale, përdorim në të cilin ai shoqërohet nga pjesëza **zu**: Brauchte ja nicht jeder gleich zu sehen. / S'kishte pse të shihnin të gjithë njësoj⁴

I shoqëruar nga folja **werden** (bëhem) infinitivi përdoret për të formuar të ardhmen.

Er wird *kommen* / ai do të vijë.

Gjithashtu i lidhur me foljen **werden** infinitivi shpreh edhe supozim⁵

Sie wird auf dem Weg zum Bahnhof *sein*. (Ajo do jetë ndoshta rrugës për te stacioni i trenit.)

Participi II

Forma tjetër e pashtjelluar e foljes në gjermanisht, që mund të dalë si pjesë e kallëzuesit është participi II ose participi i së shkuarës.⁶ Ai lidhet me foljet ndihmëse *haben* (kam) dhe *sein* (jam) për të formuar kohët e përbëra dhe kur kallëzuesi shprehet me folje në kohën e kryer ose më se të kryer (Perfekt ose Plusquamperfekt) atëherë pjesë e tij është edhe participi II ose pjesorja e foljes. Participi II shërben edhe për formimin e diatezës pësore duke u bashkuar me foljen *werden*.⁷ Edhe në këtë rast kur kallëzuesi shprehet me folje në diatezën pësore pjesë e tij është edhe participi II:

Shembuj:

Womit hab' ich den das verdient? / Pse e kam merituar këtë?

... als sie dann abgezischt war / ...kur ajo ia kishte mbathur

...ein Bediensteter, der Zeitungen gelesen hatte.../ një shërbyes, që kishte lexuar gazeta...

Er ist nicht sehr lange *geblieben*. /Ai nuk ka ndenjur gjatë.

² U. Engel, *Deutsche Grammatik*, München, 2004, f. 227 / DUDEN, *Die Grammatik*, Mannheim, 1998, f. 626.

³ Buscha / Zoch, *Der Infinitiv*, Leipzig 1992, f. 26.

⁴ Helbig / Buscha, *Deutsche Grammatik*, Berlin, 2001, f. 102.

⁵ Buscha / Zoch, *Der Infinitiv*, Leipzig, 1992, f. 28.

⁶ U. Engel, *Deutsche Grammatik*, München, 2004, f. 226.

⁷ DUDEN, *Die Grammatik*, Mannheim 1998, f. 625.

Er wird von den anderen beobachtet. Ai vëzhgohet nga të tjerët.

Er war vom Lehrer beobachtet worden. Ai ishte vëzhguar nga mësuesi.

3. Format e pashtjelluara si pjesë e kallëzuesit në shqipe.

Siç u përmend më lart edhe në gjuhën shqipe mund të dalin si pjesë të kallëzuesit forma të ndryshme të pashtjelluara të foljes. Në rastet kur format e pashtjelluara lidhen me një emër a përemër në rasën emërore, me të cilin hyjnë në marrëdhënie kallëzuesore, mund të flitet për funksion kallëzuesor të tyre⁸. Në raste të tjera ato mund të jenë pjesë e kallëzuesit.

Më shpesh si kallëzues shfaqet forma e pashtjelluar mohore e tipit *pa punuar*⁹, e cila ndryshe nga përcaktimi që i bëhet nga gramatika e Akademisë së Shkencave përcaktohet si përcjellore mohore nga Prof. Çeliku¹⁰, por pavarësisht emërimit të dyja trajtimet bashkohen në pikën kur e shohin këtë formë të pashtjelluar në funksionin e kallëzuesit.

Kallëzuesi mund të shprehet gjithashtu edhe me formën e pashtjelluar përcjellore *duke punuar* në fjali të nënrenditura mënyrore, shkakore, kushtore etj. ose paskajore për të punuar në fjali të nënrenditura qëllimore dhe në tipin e kallëzuesit folje + paskajore e së njëjtës folje si për të vajtur vajti¹¹.

Gjithashtu në funksionin e kallëzuesit mund të dalin edhe format e pashtjelluara të tipit me të ardhur e një të thënë¹².

Forma e pashtjelluar pjesore del si pjesë e kallëzuesit të përbërë, që formohet nga folja *duhet* dhe një folje në pjesore¹³. *Duhet bërë diçka për këtë*. Ky kallëzues shpreh një veprim, realizimi i të cilit është i domosdoshëm, pra ka kuptimin modal të domosdoshmërisë. Gjithashtu pjesorja mund të lidhet edhe me foljen *dua* në trajtën e saj *do* për të shprehur një veprim që duhet të realizohet¹⁴. Edhe Çeliku e sheh si kallëzues tipin *do* + pjesore¹⁵, p.sh.: *Do parë me kujdes kjo çështje*. Ai sheh si kallëzues edhe tipin *jam* + paskajore¹⁶: *Kjo është për t'u vlerësuar*. Ndërsa në sintaksën e Akademisë së Shkencave gjejmë edhe tipin e kallëzuesit folja vij + përcjellore, kallëzues që shpreh një veprim në rritje progresive. P.sh.: *Zhurma erdhi duke u shtuar*.¹⁷

Krahasimi

Siç e shohim, në të dy gjuhët disa prej formave të pashtjelluara mund të dalin si pjesë e kallëzuesit, por nëse në gjermanishte ato dalin vetëm si pjesë e

⁸ Gramatika e gjuhës shqipe 2, Tiranë, 2002, f. 179.

⁹ Gramatika e gjuhës shqipe 2, Tiranë, 2002, f. 180.

¹⁰ M. Çeliku, *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë 2000, f. 59.

¹¹ M. Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, Tiranë, 2012, f. 151.

¹² Gramatika e gjuhës shqipe 2, Tiranë, 2002.

¹³ Po aty, f. 186.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ M. Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, Tiranë, 2012, f. 154.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Gramatika e gjuhës shqipe 2, Tiranë, 2002, f. 187.

tij dhe jo si kallëzues i plotë, pasi nuk i plotësojnë të gjitha kriteret për të qenë në këtë funksion, në shqipe vëmë re se në disa raste kallëzuesi mund të shprehet me forma të pashtjelluara e në raste të tjera ato janë thjesht pjesë e tij ashtu si edhe në gjermanisht.

Nëse në gjermanisht numri i formave të pashtjelluara që dalin si pjesë të kallëzuesit është vetëm dy në shqipe ai është më i madh edhe për faktin që shqipja njih edhe më shumë forma të pashtjelluara se gjermanishtja.

Në të dyja gjuhët pjesorja del si pjesë e kallëzuesit, ndërsa përsa i përket përcjellores së shqipes që deri diku i përgjigjet participit I të gjermanishtes mund të themi se ajo shfaqet vetëm në shqipe në funksionin e kallëzuesit, ndërsa në gjermanishte jo.

BIBLIOGRAFI

Buscha / Zoch, *Der Infinitiv*, Leipzig, 1992.

DUDEN, *Die Grammatik*, Mannheim, 1998.

Gramatika e gjuhës shqipe 2, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002.

Helbig / Buscha, *Deutsche Grammatik*, Berlin, 2001.

M. Çeliku, *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2000.

M. Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, Tiranë, 2012.

U. Engel, *Deutsche Grammatik*, München, 2004.